



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1042/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 07 / 2021

V E N D I M

Nr. 133, Datë 16 / 07 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 124 Regj, datë 07.07.2021, të paraqitur nga subjekti ankues, G. S, kundër Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Arsimore (DRAP) Lezhë dhe Drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mehmet Shpendi” Shalë, Shkodër, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, G. S, është me profesion mësues i lëndëve fizikë dhe matematikë. Ai shprehet se në vitin 2020, ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe është renditur në vendin e 10 (dhjetë). Meqenëse disa nga kandidatët e renditur përpara tij kanë refuzuar vendin e shpallur vakant për mësues të lëndëve fizikë dhe matematikë, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mehmet Shpendi” Shalë, Shkodër, ky vend pune i është ofruar ankuesit nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Shkodër.

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Referuar dokumentit “Deklaratë pranimit”, me kod 26449, firmosur nga ankuesi personalisht, datë 06.10.2020, rezulton se kandidati G. S ka pranuar vendin e punës si mësues i profilit fizikë dhe matematikë, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Mehmet Shpendi” Shalë, pranë ZVAP Shkodër, me kontratë me afat.

Ankuesi është shprehur se pavarësisht faktit se ai ka nënshkruar deklaratën e pranimit të vendit të punës, ku citohet se kontrata do jetë me afat, në shpalljen vakante të këtij vendi pune, të datës 16.09.2020 nga ana e ZVAP Shkodër është cilësuar se, kontrata do ishte pa afat.

Në kushtet kur ankuesit i nevojitej ai vend pune, megjithëse vendndodhja e shkollës ishte në një zonë të largët, në fshatin Dukagjin të Shkodrës, me datë 07.10.2020 ka filluar punë, duke vijuar të zhvillojë rregullisht procesin mësimor, deri me datë 14.04.2021.

Me shkresën me nr. 2009/1 prot., datë 12.04.2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) i ka deleguar për kompetencë DRAP Lezhës, trajtimin e ankesës së drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Mehmet Shpendi” Shalë, Shkodër, mbi problematikën e krijuar në këtë institucion arsimor si rezultat i konfliktit mes shtetasit G. S me mësuesen e kësaj shkolle, S. Sh, konflikt i cili është i vazhdueshëm dhe shkon deri në atë masë sa ka cënuar procesin mësimor.

Nëpërmjet shkresës me nr. 518/1 prot., datë 14.04.2021, DRAP Lezhë i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, duke i kërkuar që bazuar në interesin më të lartë të fëmijëve, si dhe sigurisë së mësuesve të institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, të marrë masa që shtetasi G. S të ndalojë konfliktin dhe të mos çënojë procesin mësimor në shkollë, pasi nuk ka një kontratë si mësues në këtë shkollë.

Subjekti ankues është shprehur se që nga momenti i fillimit të punës dhe deri me datë 14.04.2021 kur është larguar me forcë nga shkolla nga ana e policisë, nuk ka marrë asnjë pagesë për ditët e punës dhe as nuk është pajisur me kontratë individuale pune apo ndonjë dokument tjetër emërimi. Ai ka cituar se ka kontaktuar me drejtorin e Shkollës dhe DRAP Lezhës, të cilët i kanë premtuar verbalisht se situata do rregullohet, gjë e cila nuk ka ndodhur në vijim, por është agravuar më tepër, në momentin që në shkollë është emëruar një mësuese me kontratë dhe jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”. Ankuesi, në momentin që ka ardhur në dijeni të këtij fakti, ka këkuar nga drejtuesit të Shkollës ndreqjen e situatës, duke qenë se ai po trajtohej në mënyrë të padrejtë me mësuesen S.Sh, pasi ai ishte emëruar përmes portalit, me procedurë të rregullt, dhe ende nuk kishte nënshkruar kontratë pune dhe as ishte paguar për punën e tij. Në këto kushte, ankuesi ka pretenduar se është diskriminuar pikërisht për shkak të ankimimit të tij kundrejt emërimit të paligjshëm të mësueses S. Sh.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri: *“Ndalimin e diskriminimit, dhënien e pagës sipas ligjit, si dhe vazhdimin e punës i pashqetësuar”*.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 08.07.2021, KMD, i ka kërkuar ankuesit të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet postës elektronike të datës 12.07.2021, subjekti ankues ka dërguar parashtrime, por sërish nuk ka dokumentuar shkakun pët të cilin ka pretenduar diskriminimin.

Ankuesi ka parashtruar sërish të njëjtat pretendime dhe argumenta, si dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim me ankesën e regjistruar pranë KMD-së.

Në parashtrimet e sjella nëpërmjet e-mailit, lidhur me sqarimin dhe dokumentimin e shkakut për të cilin ka pretenduar diskriminimn, ankuesi, ndër të tjera citon se: *“Punëdhënësi im, në këtë rast drejtori i Shkollës, K. N, në momentin që unë kam kërkuar të pajisem me kontratë pune sipas ligjit, ka filluar të përdorë mashtrime duke më thënë që kontratën duhet ta kërkoj tek ZVAP Shkodër. Më pas, në momentin kur në Shkollë ka ardhur një mësuese e re dhe jashtë portalit, e pajisur me kontratë pune, unë jam ankuar verbalisht tek drejtori i Shkollës. Disponoj dhe një regjistrim me personin që administron portalin, i cili pranon se mësuesja në fjalë nuk ka hyrë në punë nëpërmjet portalit. Në momentin që unë jam ankuar dhe kam kërkuar rrogën time, drejtori i Shkollës përdori si metodë largimin tim nga puna, gjoja për shkak të një konflikti me mësuesen S. Sh, kur në fakt nuk kam asnjë konflikt të tillë. ...jam diskriminuar për shkak se unë jam ankuar për të drejtat e miya ligjore dhe për mësuesen e punësuar jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”, për shkak se kërkoj të zbatohet ligji”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar³, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të*

³ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike. Përkundrazi, ankuesi ka deklaruar se është ankuar *verbalisht* tek drejtori i Shkollës apo ka biseduar *verbalisht* me drejtuesin e DRAP Le. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se thëniet e ankuesit lidhur me kundërshtimin e emërimit të paligjshëm të mësueses S. Sh apo paligjshmërive të tjera, mbeten të karakterit deklarativ dhe të padokumentuara.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, si moslidhja e kontratës së punës, mospagimi i rrogës etj. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshëmritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

Sa i takon pretendimit të tij për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvehte.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁴. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁵.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi

⁴ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

- Referuar citimit sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte “shkakun” e pretenduar prej tij.
- Komisioneri nuk ka evidentuar një karakteristikë personale ose të identifikueshme të ankuesit, e cila, në përputhje me rrethanat e çështjes të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e titullarit të Institucionit. Në rastin në fjalë, ankuesi ka evidentuar paligjshmëritë e Shkollës apo DRAP Lezhës, sipas pretendimeve të tij, por nuk ka arritur të provojë dhe dokumentojë “shkakun” për të cilin ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë me mësuesen S.Sh.
- Referuar deklarimeve të ankuesit, ai ka pohuar se ankimimin e tij kundër paligjshmërisë e ka bërë *verbalisht* tek drejtuesi i Shkollës dhe DRAP Lezhës. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ, i paprovuar apo mbështetur në prova të tjera, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.
- Po ashtu, lidhur me pretendimin e ankuesit se disponon regjistrime të cilat provojnë paligjshmërinë e emërimit të mësueses S. Sh, Komisioneri vlerëson se, këto prova ankuesi mund t’i përdorë në gjykatë për të provuar një pretendim të tillë, por nuk shërbejnë si prova para Komisionerit lidhur me provueshmërinë dhe dokumentimin e “shkakut⁶”, i cili më pas mund të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm krahasuar me mësuesen S. Sh.

Diskriminimi⁷ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të

⁶ Të denoncimit të paligjshmërive të cituara

⁷ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e

një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për trajtim të pabarabartë me mësuesen S.Sh, Komisioneri sqaron se një pretendim i tillë nuk mund të merret në shqyrtim, përse kohë ankuesi nuk ka një shkak të provuar, si pasojë e të cilit të ketë ardhur dhe trajtimi i tij i pabarabartë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Lidhur me paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi përse i takon mosformalizimit të marrëdhënieve të punës mes tij dhe punëdhënësit⁸, nëpërmjet kontratës individuale të punës, apo lidhur me mospagesën e tij nga data 07.10.2020 deri me datë 14.04.2021 nga ana e punëdhënësit, Komisioneri i sugjeron ankuesit që këto kërtime t’ia drejtojë gjykatës kompetente, si organ i caktuar me ligj për zgjidhjen e konflikteve e mosmarrëveshjeve të punës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

⁸ Fakt i cili, nëpërmjet shkresës me nr. 518/1 prot., datë 14.04.2021, DRAP Lezhë rezulton të jetë pranuar si fakt dhe nga DRAP Lezhë dhe Shkolla e Mesme e Bashkuar “Mehmet Shpendi” Shalë, Shkodër.

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, G. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit: Mospranim